



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivered	06-05-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM/SHK	2657/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.287/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.287/2022 të datës 28.03.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër organit të punësimit Agjencia për Informim dhe Privatësi në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën/ankesën e ankueses të datës 17.03.2022.
- II. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Informim dhe Privatësi, që siguroj zbatimin e vendimit sipas pikës I.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 28.03.2022 ka parashtrua ankesë me numër protokoli 1616/22 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.03/2022 të datës 14.03.2022 dhe përgjigjes se datës 21.03.2022 të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore

të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, shkeljeve procedurale dhe vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 31.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, ndërsa kjo e fundit me datë 12.04.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2022/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 287/2022 të datës 28.03.2022 e parashtruar nga ankuesja ne numër protokollit 1616/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-malin e datës 21.03.2022; E-mailin e datës 17.03.2022; E-malin e datës 14.03.2022; Vendimin me numër 03/2022 të datës 14.03.2022; Dëshminë për masën disiplinore të datës 25.02.2022; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Vendimin me NR.23/2020 të datës 21.04.2020; Vendimin me numër 53/2020 të datës 10.07.2020; Flete rekomandimin e datës 31.12.2011; Vërtetimin e datës 10.05.2016; Referencën e datës 06.02.2010; Vendimin me numër ZK-60/12 të datës 12.11.2012; Vendimin me numër 05/2014 të datës 18.12.2014; Vendimin me numër 04/2014 të datës 29.09.2014; Akt emërimit e datës 07.12.2011; E-malin e datës 17.03.2022; Certifikatën e datës 02.05.2018; Certifikatën e datës, 22-11.2017; Certifikatën e datës 15-15 Dhjetor 2016; Certifikatën e datës 03.11.2016; Certifikatën e datës 20-21 Prill.2015; Certifikatën e datës 17.01.2016; Certifikatën e datës (numri i pa dukshëm); Certifikatën e datës 13-15.Qershor.2013; Certifikatën e datës 07-08.Maj.2012; Certifikatën e datës 26-27. Prill.2021; Certifikatën e datës 17/18.Dhjetor.2012; Certifikatën 12.03.2012; Certifikatën e datës 14.01.2002; Certifikatën e datës 27.05.2002; Certifikatën e datës 05.08.2004; Referencën e datës 01.04.2016; Letër Referencën e datës 28.08.2015; Diplomën me NR.898 të datës 28.04.2004 me të cilën ankuesja mori titullin Jurist i Diplomuar; Provën shtesë të datës 05.04.2022 me numër të protokollit 1865/2022; E-mailin e datës 25.03.2022; E-mailin e datës 23.05.2016; E-mailin e datës 30.05.2016; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.03.2022 me numër të protokollit 1769/2022; Përgjigjen në ankesë të datës 12.04.2022 me numër të protokollit 2022/2022; Aplikacionin e ankueses të datës 25.02.2022; Konkursin me numër reference RN00008191 të datës 24.04.2022; Vërtetimin e datës 10.05.2016; Flete rekomandimin e datës 31.12.2011; Vendimin me numër 23/2020 të datës 21.04.2020; Vendimin me numër 03/2020 të datës 14.03.2022; Vendimin me Nr.04-V-476 të datës 08.11.2012; emaili i datës 05.05.2022 i menaxherit të BNJ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me numër protokollit 2600/202.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që të detyrohet organi administrativ kompetent gjegjësisht Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, që të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën/ankesën e ankueses të datës 17.03.2022, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur së Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi me datë 25.01.2022 ka shpallur Konkursin e hapur me Nr.Reference

RN0001662 për pozitën *Drejtor i Përgjithshëm*. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 24.02.2022 deri me datë 03.03.2022 e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja

Në fazën e vlerësimit të aplikacioneve Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi me Vendimin Nr.03/2022 të datës 14.03.2022, ka refuzuar aplikacionin e ankueses me Kod Nr.RAN0003121 të datës 25.02.2022, me arsyetimin së e njëjta nuk ka plotësuar kriteret e konkursit. Kundër Vendimit Nr.03/2022 të datës 14.03.2022 për refuzimin e aplikacionit ankuesja me emalin e datës 17.03.2022 i është drejtuar Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi që të shqyrtohet edhe një herë dokumentacioni lidhur me përvojën e punës, ndërsa me datën 21.03.2022 Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi në përgjigje të kërkesës së ankueses informon të njëjtën se nuk i plotëson kushtet e konkursit sa i përket përvojës se punës dhe se mbetet pranë Vendimit NRR03/2022 për refuzimin e aplikacionit të ankueses. Pas kësaj përgjigje ankuesja brenda afatit ligjor ushton ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.03/2022 të datës 14.03.2022 si dhe kundër përgjigjes të datës 21.03.2022 të Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, shkeljeve procedurale dhe vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ka analizuar nenin 8 të Rregullores (QRK)-Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues me të cilin është përcaktuar se: *Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak...5..Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e fundit e pranimit të aplikacioneve. 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë ose të paraqiten pranë kësaj Njësie për t'u njohur me arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurrim të mëtejshëm. 7. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse dhe me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur së Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Informim dhe Privatësi ka lëshuar vendim për ankuesen në cilësi të kandidatit aplikues lidhur me mos plotësimin e kriterëve të konkursit, ndërsa ankuesja brenda afatit ligjor parashtron kërkesë për rishqyrtim të aplikacionit, mirëpo, Njësia e Burimeve Njerëzore gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale ashtu që në lidhur me kërkesën e ankueses të datës 17.03.2021 nuk nxjerrë vendim siç kërkohet me nenin 8 paragrafi 7 të Rregullores (QRK)-Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.*

Kolegji me rastin e vendosjes ju referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht nenit 126 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Çdo kërkesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë, në qoftë se qëllimi i palës për të kundërshtuar një akt apo heshtjen administrative është mjaftueshëmërisht i qartë, andaj nisur nga kjo bazë ligjore Kolegji konstaton së kërkesa e ankueses e datës 17.03.2022 e parashtruar pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informimin dhe Privatësi konsiderohet ankesë e parashtruar*



kundër Vendimit Nr. 03/2022 të datës 14.03.2022 pasi që qëllimi i shprehur në këtë kërkesë ka qenë i qartë sepse ankuesja nuk është pajtuar me vendimin për refuzimin e aplikacionit duke kërkuar rishqyrtim të dokumentacionit lidhur me përvojën e punës, kështu që siç u tha me sipër Njësia e Burimeve Njerëzore është dashur që brenda afatit prej pesë (5) ditësh nga data e pranimit të kërkesës në fjalë të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën/ankesën e datës 17.03.2022 të parashtruar nga ankuesja.

Bazuar në rrethanat si me lartë, si dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.287/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

